

SKEDE INFORMIMI

THIRRJE E HAPUR PËR APLIKIME NËN PROGRAMIN KNOW-HOW EXCHANGE PROGRAMME (KEP) 2025 NGA CEI

Central European Initiative (CEI) është një forum ndërqeveritar rajonal i përkushtuar për të mbështetur integrimin evropian dhe zhvillimin e qëndrueshëm përmes bashkëpunimit ndërmjet dhe ndërmjet Shteteve Anëtare të saj dhe me Bashkimin Evropian, organizatat ndërkombëtare dhe rajonale si dhe me institucione të tjera publike ose private dhe organizata joqeveritare. Vendet anëtare në CEI janë: Shqipëria, Bjellorusia, Bosnje dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Çekia, Hungaria, Italia, Moldavia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Polonia, Rumania, Serbia, Republika Sllovaqe, Sllovenia dhe Ukraina.

Programi i Shkëmbimit të Njohurive (Know-how Exchange Programme (KEP)) është krijuar në vitin 2004 dhe është një instrument zhvillimi që synon të mbështesë transferimin e ekspertizës, praktikave më të mira dhe standardeve nga subjektet publike/private në BE tek kolegët në vendet jo-anëtare të BE-së brenda rajonit të CEI.

1. Qëllimi i thirrjes:

Synimi i programit CEI Know-how Exchange Programme (KEP) është mbështetja e projekteve që synojnë nxitjen e integritimit në BE të shteteve anëtare të CEI, që janë kandidatë për në BE, duke përshpejtuar reformat dhe duke miratuar *Acquis Communautaire*, në sektorët e përshkruar në Planin e Veprimit të CEI 2024-2026.

2. Çfarë mbështet thirrja:

Thirrja mbështet projektet që synojnë përmirësimin e kapaciteteve dhe asistencës teknike për vendet jo-anëtare të BE-së në rajonin e CEI, duke promovuar integrimin rajonal dhe bashkëpunimin në rrugën drejt standardeve dhe politikave të BE-së.

3. Kush mund të aplikojë:

Aplikantët duhet të jenë institucione publike dhe private, organizata ndërkombëtare dhe organizata joqeveritare që veprojnë në interes publik dhe që kanë eksperiencë në menaxhimin e projekteve.

Thirrja është e hapur për 2 lloje aplikantësh: Institucionet ofruese të njohurive dhe institucionet përfituese të njohurive.

- Institucionet ofruese të njohurive duhet të jenë nga shtetet anëtar të BE-së dhe që janë pjesë e CEI: Bullgaria, Kroacia, Çekia, Hungaria, Italia, Polonia, Rumania, Republika Sllovaqe dhe Sllovenia.
- Institucionet përfituese të njohurive duhet të jenë nga shtetet jo-anëtare të BE-së dhe që janë pjesë e CEI: Shqipëria, Bosnje dhe Hercegovina, Moldavia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia dhe Ukraina.

4. Çfarë partneriteti kërkohet:

Thirrja kërkon pjesëmarrjen e të paktën dy partnerëve për propozim. Partneriteti duhet të përbëhet të paktën nga një ofrues dhe një përfitues i njohurive. Aplikanti kryesor mund të përkojë me një institucion ofrues të njohurive ose me një institucion përfitues të njohurive.

5. Llojet e aktiviteteve të pranueshme:

Aktivitetet e projektit duhet të hartohen për të transferuar njohuritë që synojnë të mbështesin vendet përfituese në rrugën e tyre drejt procesit të integrimit në BE.

Llojet e aktiviteteve të pranueshme janë:

- trajnime në vendin e punës,
- workshope,
- dërgimi i stafit për vizita,
- vizitat studimore,
- misionet e vlerësimit të kolegëve,
- asistenca në përgatitjen e dokumenteve strategjike (p.sh. planet e zhvillimit, reformat, studimet strategjike etj.),
- transferimi i teknologjisë,
- asistenca teknike dhe ngritja e kapaciteteve.

Aplikantëve u kërkohet të deklarojnë qartë se kur pritet të fillojë dhe të përfundojë aktiviteti, si do të organizohet, kush do të jetë përgjegjës për zbatimin e tij dhe rezultatet e pritura në lidhje me objektivat e projektit. Aktivitetet e projektit rekomandohet fuqimisht të përfshijnë organizimin e një eventi përfundimtar (p.sh., konferencë, workshop ose takim promovues) që synon përhapjen dhe promovimin e rezultateve të projektit tek palët e interesuara, politikëbërësit dhe publiku i gjerë.

Aplikanti duhet gjithashtu të përshkruajë çdo aktivitet të planifikuar pasues pas përfundimit zyrtar të projektit. Të gjitha aktivitetet e projektit duhet të zhvillohen në rajonin e CEI-t dhe CEI duhet të miratojë çdo përjashtim nga ky rregull. Aplikantit i kërkohet të paraqesë një plan pune dhe një orar realist dhe të verifikueshëm. Faza e zbatimit të projektit mund të fillojë që nga 1 janari 2026. Kohëzgjatja e projektit nuk duhet të kalojë 24 (njëzet e katër) muaj, ndërsa kohëzgjatja minimale është 6 (gjashtë) muaj.

6. Cili është buxheti i thirrjes dhe për projekt:

Buxheti total për thirrjen është deri në **600,000 EUR**, ndërsa granti maksimal i alokuar për një projekt të vetëm nuk mund të kalojë shumën prej 40,000 EUR.

Grantet do të mbulojnë **vetëm 50% të kostove totale** të projektit, ndërsa pjesa e mbetur duhet të bashkë-financohet nga burimet e partnerëve ose burime të tjera.

7. Si bëhet aplikimi:

Aplikimi bëhet përmes sistemit elektronik të CEI, ku aplikanti duhet të plotësojë formularin e aplikimit dhe të bashkëngjisë tre anekse të detyrueshme (buxhetin, listën e partnerëve me ndarjen e kontributit dhe deklaratën e pjesëmarrjes në projekt).

- KEP2025_Call for Proposals
- KEP2025_Annex 1_template
- KEP2025_Annex 2_template
- KEP2025_Annex 3_template

8. Kur është afati i fundit:

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve është 26 Shtator 2025, 11:59 pm (CEST).

9. Linku i thirrjes: <https://application.cei.int/application/kep-2025/>